



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 349, Datë 22.11.2023

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 228, DATË 17.07.2023,
“MBI PËRCAKTIMIN E SHOQËRISË “BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË
ELEKTRIKE ALPEX” SH.A., SI OPERATORI I EMËRUAR I TREGUT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE (NEMO)”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.11.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1395/14 prot., datë 16.11.2023, të përgatitur nga Grupi i Punës “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 228, datë 17.07.2023, “Mbi përcaktimin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX” sh.a., si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)”

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 228, datë 17.07.2023 ka vendosur të përcaktojë shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike – ALPEX” sh.a., si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO), duke i lënë detyrë në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi përkatësisht:
 2. Brenda 2 (dy) muajve, shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., duhet të depozitojë në ERE Programin Ekonomik të vitit 2023 të ndryshuar të miratuar nga organet drejtuese të saj.
 3. Brenda 2 (dy) muajve, shoqëria Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a., të dokumentojë në ERE informacion mbi arsyet e ndryshimit të organigramës duke shpjeguar detyrat funksionale të personelit.

- ERE, me shkresën me nr. 1395/11 prot., datë 08.08.2023, njoftoi shoqërinë për vendimin nr. 228/2023, duke i sjellë në vëmendje dhe detyrimin për plotësimin e kushteve të këtij vendimi.
- Po ashtu, me shkresën nr. 1395/12 prot., ERE njoftoi për këtë vendim përkatësisht Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, Autoritetin e Konkurrencës (AK), Zyrën e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës (ZRRE), Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., Shoqatën e Furnizuesve Shqiptarë të Energjisë Elektrike (AEES), Shoqatën Shqiptare të Energjisë së Rinovueshme (AREA), si dhe Shoqatën e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA).
- Brenda afatit të përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të vendimit të bordit nr. 228/2023, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2116 prot., datë 06.09.2023, shoqëria “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike” sh.a., ka përcjellë në ERE dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar, duke plotësuar këto kushte, ndaj këto pika *vlerësohen* të shfuqizohen.
- Në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pikat 2 dhe pika 3 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 228/2023 “Mbi përcaktimin e shoqërisë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX” sh.a., si Operatori i Emëruar i Tregut të Energjisë Elektrike (NEMO)” shfuqizohen.
2. Grupi i punës, të njoftojë shoqërinë “Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike ALPEX” sh.a për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI